



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna Istog/Opština Istok/ Municipality of Istog



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural / Direkcija za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj /
Department of Agriculture and Rural development

<https://kk.rks-gov.net/istog/>

DATË/A:	07.07.2025
REFERENCE:	09 Nr.76/2025
PËR/ZA/TO:	Tabelën e shpalljeve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim



Thirrje për aplikim

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural-Komuna e Istogut në kuadër të projektit "Promovimi i fuqizimit të grave rurale në Kosovë", i implementuar nga FAO dhe UN Women, dhe i financuar nga Zyra Austriake për Zhvillim (ADA), shpallë thirrjen për aplikim për mbështetje me pajisje bujqësore.

Ky projekt synon të:

- heqë barrierat strukturore dhe të adresojë normat e dëmshme gjinore,
- përmirësojë qasjen në pronësi dhe burime për gratë në sektorin bujqësor dhe sektorët e lidhur me të,
- prezantojë teknologji që kursejnë kohë dhe punë,
- ofrojë mundësi të reja dhe inovative të financimit për gratë rurale.

Të drejtë aplikimi kanë gratë që kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga projekti.

Afati i aplikimit:

Thirrja do të jetë e hapur nga data **7 Korrik 2025 deri më 21 Korrik 2025, ora 16:00.**

Mënyra e aplikimit:

Formularët e aplikimit mund të merrën pranë zyrës së Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Istogut nr. 200.

Sesion informues:

Për të gjitha gratë e interesuara, do të organizohet një sesion informues më **9 Korrik 2025, duke filluar nga ora 10:00**, në Sallën e Asamblesë Komunale.